



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 273/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Nita Bejta - Kryetar, znj. Kimete Gashi- Anëtare, z. Agon Ramadani – Anëtarë, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anetare, , z. Vedat Poterqoi – Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Haxha Kom” - Vushtri, kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit: “Ndertimi i rrugës Lah Nimani – Mitrovice” me nr. prokurimi: 22-6315-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Mitrovicës se Jugut , më datën: 05.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ Haxha Kom” – Vushtri, kundër njoftimit për kontrate, lidhur me aktivitetin të prokurimit: “Ndërtimi i rrugës Lah Nimani – Mitrovice” me nr. prokurimi: 22-6315-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Mitrovicës se Jugut.

II. OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues lidhur me aktivitetin të prokurimit “Ndërtimi i rrugës Lah Nimani – Mitrovice” me nr. prokurimi: 22-6315-5-1-1 të bëjë përmirësimet e nevojshme për korrigjimin e njoftimit për kontrate.

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e OE ankues “Haxha Kom” – Vushtri aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 15.07.2022, “Haxha Kom” – Vushtrri ka parashtuar ankesë me nr: 273/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i rrugës Lah Nimani – Mitrovicë” me nr. prokurimi: 22-6315-5-1-1 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Mitrovicës se Jugut.

OE ankues në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 1,7,27,69, dhe 71 të LPP-së si dhe nenet 18.9 dhe 26.4 të RrUOPP-se.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 29.07.2022, në raportin e ekspertizës ka deklaruar:

Përgjigje ne pretendimin Ankimor

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Haxha Kom ka parashtuar ankese ne OSHP, ne fazën e kriterëve, i cili pretendon se AK-ja, ne dosje te tenderit ka vendosur kërkesa diskriminuese.

OE ankues pretendon se AK-ja, me kërkesën nr.2 të FDT-se, për një inxhinier të dipl. Master të ndërtimtarisë- drejtimi infrastrukture rrugore, e ka kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve, me arsyetimin se, me sistemin e vjetër arsimor ndërtimtaria ka qene e ndare ne këto drejtime: Konstruktiv, Hidro dhe Arkitekture dhe se drejtimi konstruktiv i ndërtimtarisë e ka përfshire edhe drejtimin e infrastrukturës rrugore. Pra, sipas OE ankues drejtimi infrastrukturë rrugore dhe drejtimi konstruktiv është ekuivalent apo i njëjti.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se OE ankues, nuk ka ofruar asnjë prove lidhur me pretendimin e cekur me larte se drejtimet ne fjale janë te njëjta.

Megjithatë eksperti shqyrtues, vlerëson se nëse këto dy drejtime janë te njëjta siç pretendon OE ankues, pra kane plan program te njëjte ose janë diploma ekuivalente autoriteti kontraktues nuk mund ta eliminoj një operator ekonomik, për faktin se dihet qe ka një ndryshim mes sistemeve te vjetra te arsimimit dhe sistemeve te cilat sot aplikohen, andaj dhe një pretendim i tille fare lehte mund te verifikohet pran universitetit apo lëshuesit te diplomës gjate fazës se vlerësimit te ofertave.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK-ja, me rastin e kërkesës se dosjes se tenderit ku është kërkuar që mjeshtri i betonarmesë të jetë i certifikuar nga qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës ose nëse janë të lëshuara nga jashtë Kosovës duhet të jenë të nostifikuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se AK-ja, nuk ka përmendur emra konkret se nga cila qendër e aftësimit profesional duhet të jetë certifikata për mjeshtrin e betonarmesë, por vetëm ka kërkuar që certifikata të lëshohet nga një qendër e aftësimit profesional e licencuar në Republikën e Kosovës.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, ku AK-ja, ka kërkuar: Listën e të punësuarve në kompani min. 40 punëtorë ku 60% duhet të ketë Lideri, (të ceket në listë profesioni i punëtorëve), ndërsa si dëshmi e të punësuarve në kompaninë e juaj të dhënë nga ATK.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se AK-ja, i ka dhënë një arsytim OE ankues në vendimin e kërkesës për rishqyrtim duke u bazuar në nenin 27.4 të Rregullave dhe udhëzuesit për prokurim publik, ku thuhet:

27.4 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. Kjo do të thotë se AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësisimit të kërkesave nga njeri anëtar i grupit të OE.

Eksperti shqyrtues vlerëson se neni 27.4 i RrUOPP-se, nuk lejon përcaktimin e një kërkesë të vetme me përqindje minimale, por totalin e kërkesave të përfshira në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. Prandaj kërkesën e OE ankues për ndryshim të përqindjes së punëtorëve dhe numrit të punëtorëve nga lideri dhe anëtari i konzorciumit, eksperti shqyrtues, e vlerëson si të bazuar.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar në tërësi kërkesën e cituar më lartë, vlerëson se kërkesa për dëshmi të ATK-se duhet të hiqet në tërësi dhe po ashtu të lejohet që OE-te të ketë mundësi të sigurojë punëtorë edhe përmes para kontratave për këtë projekt, për faktin se, marrë në tërësi si kërkesë është shumë ngarkuar dhe njëherit eksperti shqyrtues vlerëson se ligji i punës i parashihet para kontratave dhe në këtë mënyrë do të hapet edhe me shumë konkurrenca për këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, në vazhdim sqaron se OE ankues ka disa pretendime ankimore lidhur me pajisjet e kërkuara në dosje të tenderit, ku kërkon që disa pajisje të hiqen në tërësi si kërkesa ndërsa disa pajisjeve tjera tu ndryshohet pesha apo sasia.

Pajisjet që OE ankues kërkon që të hiqen në tërësi:

OE ankues pretendon se kërkesa për Një Damper 22 ton duhet të largohet në tërësi si kërkesë me arsytimin se janë kërkuar edhe 12 kamionë të cilët janë të mjaftueshëm për të përfunduar punët e paracaktuara në paramasë.

OE ankues pretendon se kërkesa nr. 9 për një Traktor me Kabine me luge ngarkuese me lopata rrafshuese, me arsytimin se nuk përkon me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

OE ankues pretendon se kërkesa nr. 18 për një Kamion për tërheqjen e ujërave fekale me peshe bartëse min 13.000 kg-[arsyeja është se ka nevojë të pastrohet sepse në këtë aktivitet ka edhe ndërtim dhe meremetim të kanalizimit fekal dhe atmosferik], duhet të hiqet si kërkesë me arsytimin se në asnjë pjesë të para masës AK-ja, nuk ka parapare që të pastrohet kanalizimi

ekzistues.

OE ankues pretendon se kërkesa nr. 18 për dy Makinë për gërryerjen e asfaltit 16-18 ton, duhet te hiqet si kërkesë me arsyetimin se kemi te bëjmë me ndërtimin e rrugës se re dhe nuk kemi te bëjmë fare gërryerje te asfaltit.

OE ankues pretendon se kërkesa nr. 26 për një Freze Asfalti 2-3 ton, duhet te hiqet si kërkesë me arsyetimin se kemi te bëjmë me ndërtimin e rrugës se re dhe nuk kemi te bëjmë fare gërryerje te asfaltit dhe se AK-ja nuk e ka vendosur ne para mase gërryerjen e asfaltit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues për pajisjet e lartpërmendura per te cilat kërkon qe te hiqen ne tërësi, me arsyetimin se nuk përkojnë me natyrën e aktivitetit te prokurimit siç është rasti për kërkesë për makine për gërryerjen e asfaltit, dhe se ne asnjë pike te para masës nuk janë parapare pune me te cilat do te përdorej pajisja ne fjale, dhe se disa pajisje tjera te vendosura ne liste mund ta kryejnë pune e njëjte. Per te gjitha këto pretendime eksperti shqyrtues vlerëson se qëndrojnë per faktin se ka makineri per te cilat nuk janë parapare punime ne para mase dhe po ashtu ka formulime me kuptim te dyfishte gjë qe mund ti ve ne lajthitje OE-te pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit..

Pajisjet qe OE ankues kërkon qe tu ndryshohet pesha apo sasia:

OE ankues kërkon qe kërkesa nr. 5 për Katër Ekskavator 30-35 ton dhe kërkesa nr. 6 per Dy Ekskavator 40-46 ton, te zvogëlohet ne maksimum 2-3 copë dhe njëherit te zvogëlohet tonazha e ekskavatorëve.

OE ankues kërkon qe kërkesa nr. 10, 11, 12, 13 dhe 14, për një Cilindër për ngjeshje toke min 24 ton, nje Cilindër me dhëmbëza vibrues 19-20 ton, dy Cilindër për ngjeshje toke 7-12 ton, një Cilindër për ngjeshje toke 18-20 ton, dy Cilindër per ngjeshje toke 11-14 ton, te zvogëlohet ne dy cop ose tri, dhe jo shtate sa i ka kërkuar AK-ja, ne dosje te tenderit.

OE ankues kërkon qe kërkesa nr. 15, 16 dhe 17, për dy Cilindër kombinuara(gomë - hekur) 8-11 ton, dy Cilindër kombinuara(gomë - hekur) 3-5 ton, dy Cilindër Asfalti Gome-gome 13-15 ton, te zvogëlohet ne sasia e kërkuar nga AK-ja, ne dosje te tenderit.

OE ankues kërkon qe kërkesa nr. 21, per Katër Ngarkuese 24-30 ton, te zvogëlohet sasia e kërkuar.

OE ankues kërkon qe kërkesa nr. 25, për tre Finisher per shtrirje te asfaltit, te zvogëlohet sasia e kërkuar.

Eksperti shqyrtues, sa i përket pretendimeve te OE ankues, për pajisjet për te cilat kërkon qe te ndryshohet pesha dhe te reduktohet numri i pajisjeve te kërkuara, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja e ka mbingarkuar me kërkesa për pajisje duke kërkuar pajisjet e njëjta me tonazha te ndryshme, siç është rasti tek kërkesa nr: 15 dhe 16 ku AK-ja, ka kërkuar pajisje te njëjta me tonazhe te ndryshme, ndërsa ne përgjigjen e kërkesës për sqarim nuk ka dhëne nuk ka dhëne ndonjë shpjegim te sakte se pse janë kërkuar te gjitha këto pajisje dhe vendosja e një numri kaq te madh te pajisjeve është ne kundërshtim me nenin 7 paragrafin 6 te LPP-se ku thuhet se: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik

lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues, ne dosje te tenderit konkretisht ne përshkrim te çmimit – para masën për aktivitetin e prokurimit ne fjale, e ka dhënë gjatësinë e ndërtimit te rrugës Lahë Nimani, prej: L=394.60 metra dhe duke u bazuar edhe ne praktikat tjera ne rruge me gjatësi shume me te mëdha nuk ka pasur kërkesa kaq te mëdha për pajisje.

Eksperti shqyrtues, ne fund te vlerësimit sqaron se AK-ja, me rastin e përgatitjes se dosjes se tenderit ka hartuar kërkesa te cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e operatoreve ekonomik duke kërkuar numër te madh pajisjeve dhe kryesisht ekspertit shqyrtues bazohet edhe ne nje vlerësim qe AK-ja, e ka dhënë ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim ku ka deklaruar se, citat:

Për paisjet te cilat i posedon O.E. dhe janë me kapacitet më te lartë normal qe mund te aplikoni dhe kurgja nuk te keqe dhe lejohet edhe te paisjet mund te jetë me tonazh më te lartë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se me përgjigjen e dhëne me larte autoriteti kontraktues e ka pranuar qe kërkesat janë diskriminuese ashtu siç pretendon edhe ankuesi, sepse nuk mund te arsyetohen me deklarime te tilla siç është cituar me larte. Kërkesat e dosjes se tenderit duhet te jen konkrete relevante dhe proporcionale ne raport me lenden e kontratës dhe nuk duhet te jen me tonazh me te larte se nevojat për tu realizuar ky projekt.

Eksperti shqyrtues, i propozon panelit shqyrtues qe ta obligoje AK-ne, qe te veprojnë konform nenit 53.7 te LPP-se duke përmirësuar kërkesat e sqaruara me larte dhe te zvogëlojë tonazhet dhe sasi të pajisjeve ne harmoni me kërkesat për realizimin e aktivitetit te prokurimit ne fjale dhe pas përmirësimit te kërkesave ne rast se ka kërkesa për sqarime nga ana e OE-ve, te jepen argumente te plota lidhur me vendosjen e një kërkesë.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa njoftimi për kontrate i datës: 23.06.2022, te anulohet dhe te obligohet AK-ja, qe te veprojnë konform nenit 53.7 te LPP-se duke bere përmirësimet e nevojshme.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 01 Gusht 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicës se Jugut me datën 01 Gusht 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së, duke u përgjigjur konkretisht si ne vijim:

- 1. NUK PAJTOHEMI me mendimin e Ekspertit Shqyrtues në PRETENDIMIN nr 1.ku O.E. nuk jep kurfar prove bindse se në këtë pretendim dhe ne mendojmë se kemi të drejtë sa i përketë kërkeses për ING te Dipl.Master të Ndermtarisë -Infrastrukturë Rrugore sepse kemi shumë O.E. që posedojn një profil te tillë te ING.*
- 2. PAJTOHEMI me mendimin e Ekspertit Shqyrtues në SQARIMIN e tijë se pretendimi i O.E.nuk qëndron në lidhje me kërkesen e A.K. për Mjeshter te Betonarmes për arsye se ne kemi kërkuar QERTIFIKATË nga një Qender e Aftësimi Profesional në Kosovë.*
- 3. NUK PAJTOHEM sa i përketë Mendimit te Ekspertit dhe pretendimit te O.E. ankues ku*

AK ka kërkuar listen e të punësuarve të O.E. min 40 punëtorë ku 60% duhet të ketë Lideri të ceket në listë profesioni të punëtorëve ndërsa si dëshmi të punësuarve tek O.E. të jenë nga ATK-ja.Rekomandoj të veprohet si tek VENDIMI i OSHP-së nr 250/22 ku ipet e drejta e AK të kërkojë listen nga ATK-ja vetëm për punëtorë kurse për ING të pranohen lista e ING me PARA KONTRATA për procedurën në fjalë.

4. NUK pajtohem me Mendimin e Ekspertit Shqyrtues sa i përketë nenit 27.4 e RRUOPP ku ceket se AK mund të përcaktoj në DT dhe Njoftimin për Kontratë se si OE duhet të përmbushin Kërkesat mbi Mundësitë Ekonomike/Financiare dhe Teknike/Profesionale të referuar në Nenin 68 dhe 69 të LPP-së. Kjo do të thotë se AK mund të përcaktojë një % minimale në drejtim të të plotësimit të kërkesave nga njëri Antar i Grupit të O.E. Ju Sqarojë se sa i përketë edhe kësaj pike ju PANEL i nderuar i OSHP-së para dy ditëve keni dhënë një përgjigje të VENDIMI i OSHP-së nr 250/22 ku thuhet se në këtë pikë pretendimi i O.E. NUK Qëndron.

5. Sa i përketë PAISJEVE PAJTOHEMI me mendimin e Ekspertit dhe do të largohen paisjet të cilat perseriten dhe të cilat nuk kanë të bëjnë me procedurën në fjalë dhe poashtu do të zvoglohet sasia e paisjeve ashtu siqë ka dhënë mendimin Eksperti i OSHP-së.

Operatori ekonomik ankues “Haxha Kom” - Vushtrri me datën 01 Gusht 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së.

Seanca e shqyrtimit të lëndës është mbajtur me datën: 05 Shtator 2022, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-se, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë. Marrë këtë parasysh, PSH mbështetet në ekspertizën e ekspertit shqyrtues se ankesa e OE ankuese aprovohet dhe të obligohet AK të beje përmirësimet e nevojshme për korrëgjimin e njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Marre parasysh se edhe vete AK përmes përgjigjes se tij pajtohet që disa nga kriteret duhet të ndryshohen, PSH ka vendosur se, lidhur me të gjitha pretendimet ankimore të OE ankuese ndaj të cilave AK është pajtuar që të beje ndryshimet e nevojshme, konkretisht pika 2 dhe 5 e parashtresës së AK, PSH obligon AK të beje ndryshimet konform mendimit të ekspertit ashtu që arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsye të panelit shqyrtues për të njëjtat.

Lidhur me pretendimin e pare ankimore të OE ankuese me të cilin AK nuk pajtohet, PSH duke u mbështetur në raportin e ekspertizës dhe me qëllim të rritjes së konkurrencës, vlerëson se meqë ka ndryshime mes sistemeve të vjetra të arsimit dhe sistemeve të cilat sot aplikohen, AK se duhet të beje ndryshimet në specifikacionet teknike ashtu që për pozitën Ing. të dipl. Master të Ndertimitarise – “Infrastruktura rrugore” të shtohet apo drejtimi konstruktiv (me sistem pesëvjeçar). Për këtë ndryshim duhet të konsultohet edhe njëherë njësia e kërkesës dhe të

obligohet qe ta bëjnë nje verifikim ne lidhje me mbulueshmërinë e drejtimit Infrastruktura Rrugore edhe nga drejtimi konstruktiv.

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankueses me te cilin AK nuk pajtohet me te cilin është kërkuar se listën e të punësuarve te OE min 40 punëtor ku 60% duhet ti ketë Lideri te ceket në listë profesioni i punëtoreve ndërsa si dëshmi e të punësuarve tek OE te jenë te regjistruar nga ATK-ja. PSH vlerëson, duke respektuar konsistencën e vendimeve, se kërkesa qe OE-se te ofrojnë si dëshmi qe punëtoret te jene te regjistruar ne ATK te lejohet për punëtoret si dëshmi – informatë mbi fuqinë punëtore te OE, ndërsa për inxhinieret e fushave te ndryshme specifike, PSH konsideron se dëshmia nga ATK-ja duhet te hiqet ashtu qe te lejohet qe OE-te te kenë mundësi te sigurojnë angazhim te inxhinierëve edhe përmes marrëveshjeve si dhe para kontratave.

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankueses me te cilin AK nuk pajtohet, se lista e te punësuarve ne kompani min. 40 punëtor ku 60% duhet te ketë Lideri, PSH, duke respektuar konsistencën e vendimeve, konsideron se AK ka te drejte caktimin e përqindjen se punëtoreve dhe atë bazuar ne nenin 27.4 te RrOUPP-se dhe neneve 68 dhe 69 te LPP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna e Mitrovicës se Jugut
- 1x1 OE "Haxha Kom"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.